

DITARI MUJOR SHTATOR 2024



MBI 880 MIJË TURISTË VIZITUAN SITET KULTURORE GJATË MUAJVE JANAR-GUSHT

Për periudhën Janar-Gusht 2024, sitet kulturore kanë mirëpritur rreth 875,315 vizitorë, ose 36% më shumë krahasuar me 2023.

302,384 prej tyre, vizituan Muzetë Kombëtarë, ose 26% më shumë krahasuar me 2023. Mbi 340 mijë panë Parqet Arkeologjike ose 30% më shumë krahasuar me 2023. Ndërkohë që mbi 232 mijë vizitorë kaluan momente në Kala dhe Monumente Kulture, duke e rritur numrin e vizitave për këtë vit me mbi 30% krahasuar me një vit më parë.

Në fokus dhe prioritet të MEKI, është që këto site të bëhen sa më tërheqëse, më të aksesueshme dhe të ofrojnë një eksperiencë më të mirë për të gjithë vizitorët nga e gjithë bota.

PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL, NDAHEN ÇELËSAT PËR 25 FAMILJE NË MAT

25 familje në qytetin e Matit tashmë do të kenë një banesë të re falë programit të Strehimit Social nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave. Përfituesit e këtij programi janë: 5 familje me persona me aftësi të kufizuara që tashmë do të kenë një hapësirë të përshtatshme për nevojat e tyre të veçanta, 3 nëna kryefamiljare që do të kenë një shtëpi të sigurt për t'u kujdesur për fëmijët e tyre, 2 familje me më shumë se 4 fëmijë, 12 çifte të reja dhe 3 familje të tjera në nevojë.



Ata do të strehohen në një objekt 6-katësh me një sipërfaqe 4,175 m². Objekti është i kolauduar me sistem kapot, eficiencë energjie dhe është me ashensor.

PENSIONET INDEKSOHEN ME 4.1%, PËRFITOJNË MBI 791 MIJË PENSIONISTË

Në muajin tetor pensionistët do të marrin më shumë para, pasi Këshilli i Ministrave miratoi indeksimin e pensioneve me 4.1%.

Do të jenë 791.257 pensionistë përfitues nga indeksimi. 721,705 pensionistë janë pjesë e skemës së detyrueshme (pleqëri, invaliditet, pensione familjare), ndërsa 68,613 pensionistë përfitojnë nga programe të veçanta (ish-ushtarakë, punonjës të minierave/naftës, pensione speciale shtetërore dhe skema suplementare).

Për tre muajt e fundit të 2024, efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, përlogariten në 17mln euro dhe qëllimi kryesor i këtij indeksimi tha ministri, është ruajtja e fuqisë blerëse të pensioneve përballë rritjes së çmimeve dhe inflacionit.

JAVËT KULTURORE HUNGAREZE, HOLANDEZE, BRITANIKE E KINEZE RIKTHEJNË AKTIVITETET E SHUMTA KULTURORE



Magjia e Javëve Kulturore Ndërkombëtare u rikthye sërish me plot surpriza e argëtim. Njëjtë si me grupin e parë të shteteve pjesëmarrëse në këtë edicion të tretë të JKN, çdo javë do t'i dedikohet një kulture të caktuar botërore që afrohet në sofrën mikpritëse shqiptare nëpërmjet aktiviteteve të shumta që përcjellin më së miri pasurinë e tyre kulturore.

Gjithçka vijoi nga 2 Shtatori me Hungarinë, për të vijuar me Javën Kulturore Holandeze, Britanike dhe atë Kineze, që sollën në vendin tonë argëtim e emocione pa fund.

Javët Kulturore Ndërkombëtare që do të vijojnë deri në fund të Nëntorit do të sjellin në vendin tonë nga koncertet, ekspozitat, startup-et inovative dhe jo vetëm.



4,039 BURSA NË MBËSHTETJE TË NXËNËSVE TË REGJISTRUAR NË ARSIM PROFESIONAL

4,039 bursa të shpërndara në mbështetje të nxënësve të regjistruar në arsim profesional me një fond total prej 281 milion lekësh. Bursat jepen për nxënësit në bazë të kriterëve ekonomike (të ardhurat) dhe jo-ekonomike (degët prioritare, mesatarja shkollore, etj).

Përmes kësaj mbështetje synohet integrimi në arsim profesional të çdo nxënësi, por edhe mbështetja e degëve prioritare të ekonomisë.

MEKI PJESË E KONFERENCËS “BALLKANI PERËNDIMOR, SI NJË RAJON EKONOMIK NË RRUGËN DREJT BASHKIMIT EVROPIAN”, MBAJTUR NË GJERMANI

Arritjet e Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes CEFTA dhe Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal, u bënë me dije në konferencën “Ballkani Perëndimor, si një rajon ekonomik në rrugën drejt Bashkimit Evropian”, mbajtur në Gjermani. Përfaqësues nga MEKI shprehën gjithashtu përparimet e rëndësishme të Shqipërisë në lehtësimin e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe në lëvizjen e lirë të punonjësve, gjë që ka sjellë një rritje të dukshme të volumit tregtar dhe ka forcuar bashkëpunimin institucional rajonal.





“FESTIVALI NDËRKOMBËTAR TË DANCIT BASHKËKOHOR” NGA ANGELIN PRELJOCAJ GJALLËRON TIRANËN

Nën udhëheqjen artistike të koreografit me famë ndërkombëtare Angelin Preljocaj, erdhi në Tiranë për të tretin vit radhazi, “Festivali Ndërkombëtar të Dancit Bashkëkohor”. Festivali nisi magjishëm në Teatri Kombëtar të Operas dhe Baletit, me interpretimin bashkëkohor të jashtëzakonshëm të klasikes së baletit, “Liçeni i Mjellmave”. Një përzierje e përsosur e elegancës dhe dramës, e shoqëruar nga tingujt e pavdekshëm të Tchaikovsky-t, mbushi skenën me emocion dhe art.

KËSHILLI I INVESTIMEVE: DO RRISIM KONKURRUESHMËRINË E PRODUKTEVE SHQIPTARE NË TREGJET E BE




Adresimi i Sfidave “Për Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Aksesit në Tregje të Produkteve Shqiptare Me Standarde Evropiane”, ishte kryefjala e mbledhjes së dytë për vitin 2024 të Këshillit të Investimeve.

Rëndësia e bashkëpunimit midis qeverisë dhe sektorit privat është kyçe për të rritur konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në tregjet evropiane dhe nevojën për përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e ekspertizës dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit midis sektorëve publik dhe privat.

BLERTA RAMA MERR POSTIN E ZV. MINISTRES NË MINISTRINË E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Znj, Blerta Rama do të jetë zëvendësministërja e re e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Rama, pas disa diplomimeve në Universitetet më me zë të Italisë dhe jo vetëm, ka mbajtur pozicione të rëndësishme në disa institucione. Ajo ka përvijë në Banka Mediolanum, ku ka marrë pjesë në zhvillimin e shërbimeve të projektit fintech “Floëe” dhe ka menaxhuar aktivitete kontabël. Në Deloitte Business Solutions, ajo ka mbajtur rolin e këshilltares financiare në fushën e Teknologjisë dhe Performancës për Institucionet Financiare. Ndërsa eksperiencia e saj e fundit si “Menaxher Financiar dhe Projekti” në Corporate Venture ka qenë thelbësore për krijimin dhe analizën e planeve strategjike për startup-et.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA, LEJOHET TRANSFERIMI TEK ARSIMI PROFESIONAL GJATË GJITHË VITIT TË PARË

Nënshkruhet marrëveshja që i hap rrugën të rinjve që të transferohen në institucionet e arsimit profesional gjatë gjithë vitit të parë të gjimnazit.

Ky vendim krijon më shumë fleksibilitet dhe liri vendimmarrjeje për nxënësit.



MBAHET KONFERENCA PËR GJETJET E RAPORTIT TË OECD MBI KONKURRUESHMËRINË PËR BALLKANIN PERËNDIMOR 2024

Gjetjet e Raportit të OECD mbi Konkurrueshmërinë për Ballkanin Perëndimor 2024, kanë konstatuar progres të Shqipërisë në 14 nga 15 fusha krahasuar me një vit më parë. Përparimi i Shqipërisë u evidentua në fusha si: Politikat e anti-korrupsionit, punësimit, turizmit, tregtisë, bujqësisë, edukimit dhe digjitalizimit, energjisë dhe aksesit në financë.

Në konferencën e mbajtur në Tiranë, u diskutua edhe mbi hapat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e mëtejshëm në fushat e tjera, ku BE dhe OECD garantuan mbështetjen e tyre të plotë.



NIS ME ARTISTËT SERIA E TAKIMEVE “ZËRAT E KULTURËS”

Ka nisur seria e takimeve “Zërat e Kulturës”, një nismë e përbashkët e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe United Nations Association Albania, që synon të përfshijë artistët në vendimmarrjen kulturore. Gjatë takimit, artistë dhe përfaqësues të organizatave të arteve pamore, diskutuan sfidat dhe mundësitë për një të ardhme më të fortë për kulturën tonë. Pas bisedës së hapur me Znj. Lira Pipa, Zv.Ministre e MEKI, e në bashkëpunim me ekspertën britanike Gilly Campbell, pjesëmarrësit ndanë ide dhe krijuan një hapësirë të hapur për dialog konstruktiv me institucionet. “Zërat e Kulturës” do të vazhdojnë edhe për fushat e tjera.



MEKI PJESË E KONFERENCËS SË 3-TË RAJONALE TË "BALKANOMICS"

Vizioni i qeverisë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe integrimin në Bashkimin Evropian, si dhe rëndësia e reformave administrative dhe ekonomike, duke nënvizuar rolin e ekonomisë së gjelbër si një shtyllë kyçe për të ardhmen, ishte fokusi i diskutimeve në konferencën e 3-të rajonale të "Balkanomics". Gjatë kësaj konference u diskutua edhe mbi disa strategji të rëndësishme që kanë për qëllim përmirësimin e politikave ESG dhe krijimin e sinergjive mes qeverisë dhe sektorit privat. Balkanomics mbledhi së bashku liderë dhe ekspertë ndërkombëtarë, të cilët ndanë përvojat e tyre për të ndihmuar në ndërtimin e rrjeteve dhe strategjive për zhvillimin ekonomik.



PRAKTIKAT MË TË MIRA NË LIGJIN PËR STATUSIN E ARTISTËVE DISKUTOHEN NË KONFERENCËN "DREJT POLITIKAVE KULTURORE NOVATORE"


Praktikat më të mira në ligjin për statusin e artistëve dhe ndikimi në artin shqiptar, u diskutuan mes ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, Suedia dhe Shqipëria në konferencën "Drejt politikave kulturore novatore".

Për të hapur një kapitull të ri për artin në vend, duhet identifikuar sfidat me të cilat përballen artistët. Qëllimi i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është edhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar për artistët. Mes prioriteteve është edhe zhvillimi i industrisë Kreative dhe Kulturës, si një sektor kyç për ekonominë e Shqipërisë.



MBI 23 MIJË PUNËKËRKUES U NDËRMJETËSUAN NË TREGUN E PUNËS GJATË JANAR-GUSHT 2024

Përmes shërbimeve të ofruara për punëkërkuesit e grupeve të veçanta nga Zyrat e Punës dhe Qendrat e Formimit Profesional, për periudhën Janar-Gusht 2024 është mundësuar ndërmjetësimi në tregun e punës përmes shërbimeve të punësimit për 7,824 të rinj deri 29-të vjeç. Gjithashtu kanë përfituar mbi 11 mijë gra dhe vajza, si dhe 967 të papunë nga komuniteti Romë dhe Egjiptianë. Fokus të veçantë ka pasur edhe për 2,638 individë, përfitues të ndihmës ekonomike ose kanë marrë formim profesional. Misioni i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të vijojë të jetë mbështetja dhe aftësimi i çdo punëkërkuesi.





“PIKË UJI” ZGJIDHET SI FILMI PËRFAQËSUES I SHQIPËRISË NË OSCAR

I prodhuar në vitin 2024, filmi shqiptar “Pikë Uji” është përzgjedhur Qendra Kombëtare e Kinematografisë për të përfaqësuar Shqipërinë në kategorinë “International Feature Film”, në edicionin e 97-të të Çmimeve OSCAR.

Ky film, me regjisor Robert Budina dhe me skenar po të Budinës, Doruntina Basha dhe Ajola Daja, është një thriller emocionues që zbulon çmimin e vërtetë të pushtetit dhe dashurisë prindërore.

QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË SË SHQIPËRISË BËHET ANËTARE E "EUROPEAN FILM AGENCIES DIRECTORS"



Qendra Kombëtare e Kinematografisë së Shqipërisë bëhet anëtare e European Film Agencies Directors.

Vendimi për pranimin e QKK-së si anëtarin e 38-të që u realizua gjatë takimit të fundit të kryesisë që u mbajt në Festivalin e Filmit të Venecias, ishte unanim.

ZHVILLOHET SESIONI INFORMUES PËR PROGRAMIN CREATIVE EUROPE

Në sesionin informues për Programin Creative Europe, profesionistë nga fushat e artit, sektorit audiovizual dhe medias, u njohën nga afër me mundësitë e jashtëzakonshme që ofrohen për të mbështetur dhe fuqizuar kreativitetin dhe bashkëpunimet ndërkombëtare. Znj. Lira Pipa, Zv. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, shprehu entuziazmin për vazhdimin e këtij programi edhe për tre vitet e ardhshme, duke theksuar se ky është një moment i shkëlqyer për komunitetin artistik shqiptar në zhvillimin e mëtejshëm profesional.



MEKI PJESË E TAKIMIT MINISTERIAL TË KE PËR PLATFORMAT DREJTUESE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

U zhvillua në Shkup të Maqedonisë së Veriut, takimi Ministerial i Komisionit European për Platformat Drejtuese të Ballkanit Perëndimor mbi Edukimin, Trajnimin, Kërkimin, Inovacionin dhe Kulturën. Delegacioni shqiptar i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit u fokusua në temat më të rëndësishme të momentit për inovacionin në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin profesional, duke diskutuar programet transformative si EU4Innovation dhe zhvillimin e e Strategjisë 3S të Specializimit Smart.



SHKOLLA PROFESIONALE "ARBEN BROCI" NË SHKODËR DO TË RIKONSTRUKTOHET SË SHPEJTI

"Arben Broci" në Shkodër, një ndër shkollat e arsimit profesional, së shpejti do të transformohet totalisht pas një projekti të mirëmenduar dhe një fondi të vënë në dispozicion nga qeveria shqiptare. Kjo shkollë, e ndërtuar në vitin 1968, do të kthehet në një shëmbëlltyrë të ambicies për Shqipërinë 2030, tha ministri i MEKI, Z. Blendi Gonxhja. Në këtë institucion arsimor marrin dije në drejtime si Shërbimet e mjeteve të transportit, Mekanikë, Elektroteknikë, Termohidraulikë dhe Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK), mbi 396 nxënës.



ZBULOHET VARREZA E LASHTË NË SHËNMRI TË TIRANËS

Një varrezë që daton në dy periudha historike të rëndësishme, atë helenistike dhe mesjetare, u zbulua nga arkeologët e Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik pranë IKTK-së në fshatin Shënmri të Tiranës. Lajmi është publikuar në rrjetet sociale nga ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe i Inovacionit, Blendi Gonxhja, i cili tha se ky është një zbulim i jashtëzakonshëm arkeologjik, dëshmi e kulturës arbërore. Sipas tij ky zbulim unik hedh dritë mbi historinë dhe jetën e banorëve të lashtë të kësaj zone. Gjatë gërmimeve, arkeologët kanë zbuluar në strukturat funerale edhe enë qeramike, stoli prej argjendi, bronzi, hekuri dhe qelqi, si dhe armë dhe objekte personale.

